



NJOFTIM PËR MEDIA

Bordi i ZRRE mban takimin e parë për vitin 2016

Njoftojmë publikun se me 28 dhe 29 janar 2016, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka mbajtur seancën e tij të parë për vitin 2016. Në këtë seancë, Bordi ka shqyrtuar 32 pika ku janë përfshirë çështje të ndryshme të sektorit të energjisë në Kosovë.

Pikat e para që janë shqyrtuar nga Bordi kanë pasur të bëjnë me Procesin e Autorizimit të ndërtimit të kapaciteteve të reja energjetike. Bordi pas shqyrtimeve të kërkesave ka marrë vendim të lëshojë Autorizimet për tu ndërtuar edhe 7 gjeneratorë të tjerë. Gjashtë nga këta gjenerator janë Hidrocentrale (HC) dhe 1 me panele djellore (solare). Kapaciteti i përgjithshëm i këtyre gjeneratorëve arrin në **37 MW**.

Më herët ZRRE ka Autorizuar për ndërtim edhe 9 gjenerator (njësi) të tjera, me kapacitet total të instaluar prej **40 MW**. Prej tyre tre gjenerator (dy HC dhe një me panele diellore) veç janë ndërtuar dhe janë duke operuar/prodhuar energji elektrike nga Burimet e Rinovueshme të Energjisë (BRE), ndërsa gjashtë (6) gjeneratorë të tjerë janë në faza të ndryshme të ndërtimit.

Në seancë janë shqyrtuar edhe disa aplikacione të tjera të cilat janë në faza më të hershme të aplikimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese, për të cilat Bordi ka vendosur që t'ju lëshojë autorizime preliminare në mënyrë që t'i nxisë dhe përkrah në proceset e tyre të aplikimit. Në përgjithësi deri më tani ZRRE ka lëshuar Autorizimet për ndërtimin e 16 gjeneratorëve të rinj dhe kapaciteti i përgjithshëm i instaluar i tyre është rreth **77 MW**. Nga numri i përgjithshëm i të gjithë gjeneratorëve të rinj nga Burimet e Rinovueshme të Energjisë, 14 janë Hidrocentrale dhe 2 me panele solare.

Po ashtu në këtë seancë Bordi ka shqyrtuar dhe aprovuar Planin Zhvillimor 2016 - 2025 të Operatorit të sistemit të Transmisionit. Objektivi kryesor i këtij plani është identifikimi i projekteve të cilat do të rrisin kapacitetin, besueshmërinë, efikasitetin e operimit të rrjetit transmetues me qëllim të mbështetjes së drejtpërdrejt të sigurisë së furnizimit të konsumatorëve me energji elektrike kualitative.

Në seancë Bordi ka shqyrtuar edhe disa ankesa të konsumatorëve, apelime të vendimeve të Departamentit për Mbrojtje të Konsumatorëve (DMK) nga KESCO si dhe çështje të tjera të brendshme që kanë të bëjnë me funksionimin e ZRRE-së.

Po ashtu ZRRE njofton se për shkak të agjendës së ngjeshur Bordi nuk ka arritur të shqyrtojë edhe disa pika të tjera të përfshira në agjendë të cilat do të shqyrtohen në takimin e ardhshëm.